

## **PLATFORMA E USHTRIMIT TË FUNKSIONIT TË ANËTARIT TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

### **➤ Njohje me profilin e kandidatit**

Ka filluar ushtrimin e profesionit më 1 maj të vitit 1994, në pozicionin e hetuesit/oficerit të policisë gjyqësore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës. Në dhjetor të vitit 1997 është emëruar prokuror në Prokurorinë e Rrethit Has dhe njëkohësisht ka ushtruar detyrën e drejtuesit të kësaj prokurorie, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në suprimimin e kësaj prokurorie në muajin korrik të vitit 1998. Më pas, ka vazhduar të ushtrojë detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës. Në muajin maj të vitit 2002 është transferuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë, në të cilën ka ushtruar detyrën e drejtuesit të prokurorisë deri në muajin prill të vitit 2008. Më pas, për 4 muaj është komanduar si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës. Nga muaji shkurt i vitit 2009 e deri në nëntor të vitit 2013 ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga muaji nëntor i vitit 2013 deri në 15 mars 2016 ka ushtruar detyrën e drejtuesit të prokurorisë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin. Më 15 mars të vitit 2015 është komanduar në detyrën e drejtuesit të prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe pas mbarimit të komandimit në këtë prokurori, më 16 korrik të vitit 2016 është emëruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më 15 korrik të vitit 2017 është komanduar në detyrën e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin detyrë të cilën e ka ushtruar deri në muajin prill të vitit 2018. Nga muaji prill i vitit 2018 dhe në vazhdim ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

### **➤ Shtysat në nismën e kandidimit**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), përbën një nga risitë më themelore të Reformës në Drejtësi, i cili ka marrë jetë juridike me ndryshimet kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016. Ekzistenca e KLP-së ka në bazë të saj garantimin e pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.<sup>1</sup> Ky argument shkon edhe më tej duke e parë, në veçanti KLP-në si një garanci për pavarësinë individuale të prokurorëve, e cila përbën ndryshimin kardinal të shumëkërkuar, dhe të gjithëpranuar nga aktet më të rëndësishme ndërkombëtare. Efektiviteti i këtij institucioni është shkak determinant nga i cili varet arritja e këtij qëllimi.

---

<sup>1</sup> Shih nenin 149/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ky realitet i ri juridik, institucional, shëndërrohet në vetvetë në një shtysë për çdo prokuror, që beson në këto vlera, të bëhet pjesë e tyre dhe të kontribuojë, qoftë edhe në mënyrë modeste, në suksesin dhe efektifitetin e KLP-së. Duke besuar në to, shpreh angazhimin, motivimin maksimal për t'u bërë pjesë e saj.

Ndikimi i përvojës profesionale ishin një nga shtysat kryesore për të ndërmarrë këtë hap kaq të rëndësishëm. Gjithashtu ka ndikuar ndjeshmeria e lartë ndaj mundësisë për të kontribuar në forcimin e rolit dhe statusit të prokurorit, sipas standarteve më të larta. Në këtë drejtim një ndihmesë e fortë do të jetë përvoja ime si drejtues në disa prokurori, si: Has, Krujë, Kurbin dhe Lezhë. Gjatë kësaj periudhë kam nxjerrë akte nënligjore (urdhëra, vendime dhe udhëzime), duke normuar aspekte proceduale administrative të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, sipas kërkesave të ligjit procedural penal dhe standarteve më të larta. Gjatë gjithë përvojës time profesionale, kam bërë përpjekjet maksimale për të garantuar pavarësinë, progresin profesional, dhe forcimin e integritetit të prokurorit. Gjithashtu eksperiencia e fituar gjatë gjithë kësaj periudhe prej rreth 27 vjetësh e punës time në prokurori, puna në disa prokurori, në atë të Hasit, Kukësit, Krujës, Kurbin, Lezhës, Durrësit dhe Tiranës, në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore, në atë të prokurorit dhe të drejtuesit të prokurorisë, duke bërë të mundur njohjen në detaje të problematikave dhe realitetit të sistemit të prokurorisë, do të jetë një ndihmë e shtuar në këtë drejtim.

### ➤ **Qasja e platformës**

Në fakt kjo platformë pasurohet çdo ditë nga mendimet dhe propozimet e kolegëve. Jam i hapur të ndaj me ju radhën e kryerjes së veprimeve në funksion të garantimit të pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.

**Gjithçka në funksion të garantimit të paansisë, pavarësisë, disiplinës, statusit dhe të karrierës në sistemin e prokurorisë.**

Duke marrë në konsideratë, rëndësinë e organit të prokurorisë për shoqërinë në tërësi, përgjegjësinë, që buron nga ky pozicion, të ndërthurura me vështirësitë dhe sfidat e krijimit rishtazi të saj, kërkojnë një përkushtim, vëmendje, vullnet dhe punë madhore për të synuar arritjen e qëllimeve, për të cilat është determinuar.

Në këtë kuptim ju ftoj në një udhëtim të përbashket për të arritur dhe zhvilluar me tej standartet e shumëkërkuara lidhur me garantimit e pavarësisë, paansisë, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë.

Të nderuar kolegë, unë vij sot tek ju nëpërmjet një serë objektivash realizimi. i të cilave mendoj se do të bëj të mundur forcimin e statusit të prokurorit, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij.

## ➤ Premisat e platformës dhe plani strategjik

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, është organ kushtetues,<sup>2</sup> i cili përbëhet nga 11 anëtarë, gjashtë prej të cilëve zgjidhen nga prokurorët e të gjitha niveleve të prokurorisë dhe pesë anëtarë zgjidhen nga Kuvendi, nga radhët e juristëve joprokurorë.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ushtron këto përgjegjësi: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon prokurorët e të gjitha niveleve; b) vendos për masat disiplinore ndaj prokurorëve të të gjitha niveleve; c) i propozon Kuvendit kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, sipas ligjit; ç) miraton rregullat për etikën e prokurorëve dhe mbikëqyr respektimin e tyre; d) propozon dhe administron buxhetin e tij; dh) informon publikun dhe Kuvendin mbi gjendjen e prokurorisë; e) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.<sup>3</sup>

Të qenit anëtar i kësaj strukture kaq të madhe dhe komplekse sa KLP-ja dhe shëndërimi i saj në një organ të qeverisjes së prokurorëve, sipas standarteve, aq të nevojshme për shekullin 21-të, kërkon një ide përfundimtare se ku jemi dhe ku shpresojmë të arrijmë. Në këtë aspekt rëndësi themelore merr hartimi dhe zbatimi i një strategjie të saktë, gjithëpërfshirëse, bashkohore, e harmonizuar me strategjinë e KLP-së në terësi.

Përcaktimi i strategjisë për ushtrimin e funksionit të anëtarit të KLP-së mundëson nominimin dhe ndjekjen e objektivave thelbësore për suksesin e misionit, që ka ky institucion, duke u dhënë vlerën e duhur burimeve në dispozicion, për t'i arritur këto objektiva, duke përqafuar progresin gjatë evoluimit, duke identifikuar dhe adresuar problematikat e hasura, dhe më e rëndësishmja arritja konsistente e rezultateve.

Ky proces ofron një metodë zyrtare për përcaktimin, komunikimin, harmonizimin, zbatimin dhe vlerësimin e strategjisë, për ta bërë atë pjesë esenciale të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së këtij institucioni. Përcaktimi i strategjisë siguron një kornizë të qartë ekzekutimi, operimi, dhe ndërveprimi.

Anëtarët e KLP-së duhet të zhvillojnë takime periodike me Drejtuesit dhe prokurorët e Prokurorisë, pavarësisht ndërveprimit të përditshëm, me fokus rishikimin e strategjisë për objektivat primarë, masat dhe iniciativat që duhet të ndërmerren. Gjatë këtyre takimeve, do të diskutohet mbi performancën dhe vendimmarrjen e KLP-së, në mënyrë të tillë, që të përmirësojnë funksionimin dhe rezultatet e shumëpritura.

<sup>2</sup>Shih nenin 149 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

<sup>3</sup>Shih nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

Para së gjithash, Strategjia e KLP-së duhet të përpilohet në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e tjerë të KLP-së, si dhe në harmoni me strategjinë Kombëtare të Sigurisë, me strategjinë e Prokurorisë dhe plani i saj i veprimit, rekomandimet e Këshillit të Ministrave, rekomandimet e Komisionit European dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë.

Strategjia e prezantuar në vijim është dizenuar horizontalisht dhe vertikalisht, me qëllim arritjen e efektit maksimal. Për të komunikuar strategjinë janë vënë në fokus tre aspekte, të cilat përfshijnë:

- Panorama e strategjisë, e cila siguron një vizualizim holistik se si vizioni, misioni, vlerat thelbësore, si dhe objektivat strategjike lidhen me njëri-tjetrin.
- Shtyllat e strategjisë, të cilat tregojnë fushat në të cilat duhet të përqëndrohemi për të realizuar vizionin tim gjatë kohëzgjatjes së mandatit.
- Matesi i strategjisë, i cili mat përparimin dhe informon anëtarin e KLP-së për përpjekjet e bëra drejt përmbushjes së objektivave.

- **Misioni**

Funksioni i anëtarit të KLP-së do të ushtrohet duke patur si mision sigurimin e një sistemi të pavarur, të paanshëm, profesional dhe efektiv të hetimit dhe ndjekjes penale nga prokurorët e rekrutuar në bazë të meritës, të vlerësuar në bazë të rezultateve në punë e të mbikëqyrur sipas standardeve të larta, si dhe ofrimi i resurseve adekuate humane dhe infrastrukturore.

- **Vizioni**

Vizioni është të mundësojmë ofrimin e drejtësisë në mënyrë efikase, efektive, transparente, llogaridhënëse dhe profesionale, i cili siguron besimin e publikut.

- **Vlerat**

Ushtrimi i funksionit të anëtarit të KLP-së duhet të karakterizohet nga vlerat, si:

- ❖ Realizimi i mandatit në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje nga pushtetet tjera;
- ❖ Qasja e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë;
- ❖ Integriteti dhe etika e lartë;
- ❖ Promovimi i qasjes së barabartë në shërbimet e sistemit të prokurorisë për të gjithë pa dallim;
- ❖ Realizimi i detyrave dhe mandatit në bazë të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
- ❖ Avancimi i vazhdueshëm i sistemit të administrimit dhe menaxhimit;
- ❖ Promovimi i bashkëpunimit dhe respektimi i standardeve ndërkombëtare lidhur me planifikimin dhe llogaridhënien;
- ❖ Ofrimi i shërbimeve profesionale, efikase, efektive dhe të bazuara në ligj.
- ❖ Të qenit transparent në vendimmarrje;

- **Objektivat**

Synimi im kryesor është ngritja e vazhdueshme të efikasitetit dhe efektivitetit në orientimin e politikave dhe planeve strategjike të sistemit të prokurorisë. Synimet e këtij sistemi në arritjen e vizionit të përcaktuar me këtë platformë dhe mandatit të përcaktuar me kushtetutë dhe ligj, janë të përmbledhura në shtylla strategjike. Secila shtyllë strategjike përmban objektiva specifike dhe të matshme, ku secila prej tyre konkretizohet me veprime konkrete. Realizimi i objektivave do të bëhet përmes analizave të vazhdueshme të funksionimit të sistemit të prokurorisë në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorin e Përgjithshëm, duke përcaktuar aktivitete të detajuara, të matshme dhe koherente për zbatimin e këtyre politikave dhe planeve strategjike.

Objektivat strategjike do të jenë si në vijim:

- ✓ **Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të administrimit të prokurorisë.**

Këshilli dhe anëtarët e tij kanë punuar në vazhdimësi për avancimin e sistemit të prokurorisë dhe janë të dukshme rezultatet e arritura. Megjithatë duhet të shtohen përpjekjet për rritje e metejshme të buxhetit, e cila do të mundësojnë kryerjen e mandatit ligjor më me kompetencë. Këshilli duhet të bëjë përpjekje të mëdha në drejtim të rritjes së numrit të prokurorëve krahasuar me vitet e mëparshme dhe të rrisë dukshëm numrin e stafit mbështetës. Aktualisht ekziston një ngarkëse e rritur e punës së prokurorëve madje në disa raste shqetësuese. Si anëtar i KLP-së do të përqëndroj vëmendjen në gjetjen e modaliteteve, nëpërmjet mundësisë së rritjes së numrit të prokurorëve, si dhe rialokimit të tyre.

Gjithashtu, duhet ngritur sistemi i planifikimit të punës, për të realizuar mbikëqyrjen e proceseve të punës. Më pas duhet synuar konsolidimi dhe fuqizimi i mëtejshëm i proceseve të punës në funksion të kryerjes së mandatit më me profesionalizëm, llogaridhënie, transparencë dhe efektivitet. Në këtë drejtim, synohet që takimet e Këshillit të mbahen edhe më shpesh, të jenë edhe më të përgatitura si dhe çdo pikë e rendit të ditës të kalojë në proceset e konsultimit brenda komisioneve të tij. Kjo do të synohet të bëhet edhe përmes avancimit të planeve të punës dhe raportimit të rregullt të secilit komision, hartimit të politikave të bazuara në vlerësim të thellë dhe standarde të larta. Këshilli bazuar në këto politika do të krijojë edhe mekanizma të mbikëqyrjes dhe realizimit të prioritetëve të përcaktuara.

Për më tepër duhet të investohet në përmirësimin e kushteve të punës dhe shërbimeve tjera në infrastrukture. Sot vetëm disa prokurori ofrojnë mundësinë që gjykata dhe Prokuroria pranë saj të kenë të njëjtën godinë, apo infrastruktura. Prokurorët janë të detyruar që të lëvizin, madje me disa kilometra për të marrë pjesë në seancat gjyqësore. Kjo ka krijuar vështirësi të mëdha në administrimin e punës individuale të prokurorëve, duke sjelle zvarritje të hetimeve, hetime të përcipta dhe në disa raste joefektive.

Gjithashtu në godinat aktuale të pjesës dërmuese të prokurorisë prokurorët nuk ofrojnë kushte mbështetëse për prokurorët. Shumë prej tyre nuk ofrojnë mundësi parkimi, zyrat janë të

vogla, dhe për shkak mungese disa prokuror qëndrojnë në një zyrë. Gjithashtu mungojnë kushtet e ruajtjes fizike të tyre. Rëndësi themelore merr krijimi i stafit mbështetës të prokurorit, nëpërmjet ndihmësit, apo sekretarit.

- ✓ **Rishikimi i paketës së akteve nënligjore.** Këshilli ka treguar rezultat të dukshëm në hartimin në tërësi të kornizës nënligjore, gjë që ka bërë të mundur të krijohen praktika të punës efikase dhe transparente si dhe të fokusuara në rezultate të planifikuara dhe të matshme. Megjithatë ndryshimi i vazhdueshëm i legjislacionit, si rezultat i përshtatjes me *acquis communautaire* të BE-së dhe pengesave të shfaqura në zbatimin praktik të tij, shtron nevojën e rishikimit dhe plotësim ndryshimit të akteve nënligjore të Këshillit. Duhet të synohet që përmes akteve nënligjore të rishikuara do të avancohen proceset e punës dhe të ngritet efikasiteti, efektiviteti dhe mbikqyrja e sistemit të prokurorisë. Në anën tjetër, Këshilli do të ketë rol proaktiv në ndryshimet ligjore që rregullojnë aspekte të sistemit të drejtësisë përmes kontributit në koncept-akte, propozim-ndryshime të dispozitave ligjore, pjesëmarrje në grupe punuese, tryeza shkencore dhe aktivitete të ngjashme që avancojnë drejtësinë penale dhe sistemin prokurorial në veçanti. Në këtë drejtim, prioritet do të jetë kontributi në procesin e rishikimit funksional të aktet që normojnë sistemin e karrierës dhe të transferimit për të rritur besimin e prokurorëve në vlerësimin e meritokracisë. Ata duhet të kujden për performancën e tyre dhe zhvillimi në karrierë duhet të jetë i garantuar proporcional me performancën.
- ✓ **Mbikqyrje sistematike e punës së prokurorëve dhe prokurorisë në funksion të fuqizimit të integritetit dhe mbikqyrjes.** Mbikqyrja e punës së prokurorëve është ndër elementet më të rëndësishme për një sistem prokurorial profesional dhe etik, i cili do të jetë në mbrojtje të vlerave më të larta të shoqërisë. Prandaj në vazhdimësi duhet angazhuar për krijimin e mekanizmave që mbikëqyrin proceset e punës dhe respektimin e rregullave të normuara përmes akteve nënligjore. Në këtë drejtim, mekanizmat aktualë do të fuqizohen me qëllim të realizimit të kontroleve të rregullta në mbikëqyrjen e pranimit dhe regjistrimit të materialeve, unifikimit të praktikave të punës, përcaktimit të politikave në funksion të fuqizimit të llogaridhënies dhe integritetit. Duhet bërë një vlerësim i tërë legjislacionit sekondar dhe mekanizmave aktualë dhe varësisht nga të gjeturat do të përcaktojnë sistemin e mbikëqyrjes së punës së prokurorëve dhe prokurorisë, vlerësimin të integritetit dhe rritjes së llogaridhënies në funksion të ngritjes së efikasitetit, efektivitetit dhe sundimit të rendit dhe ligjit. Llogaridhënia do të fuqizohet edhe përmes informimit të duhur dhe mundësive që iu krijohen prokurorëve dhe personelit administrativ që të marrin përgjigjet në çështjet e rregulluara me norma nënligjore të Këshillit dhe përgjigje në dilemat e ndryshme etike që mund të ballafaqohen. Në këtë drejtim do të ketë hartim të udhëzuesve dhe takime informuese për kodin e etikës, përfshirë dhe krijimin e mekanizmave përkatës sipas standardeve të pranueshme. Llogaridhënia nuk duhet të shikohet apo përdoret si mjet ndëshkimi për prokurorët, apo si qëllim i tillë në vetvete. Prokurori brenda kornizës etike dhe ligjore duhet të ndihet i pacenuar.

- ✓ **Avancim i sistemit të rekrutimit, transferimit, ngritjes në detyrë të prokurorëve.** Rekrutimi i prokurorëve në vitet e fundit ka qenë ndër prioritetet kryesore të Këshillit, për shkak të vakancave që janë duke u krijuar. Megjithatë duhet të realizohen procese kredibile të rekrutimit, ngritjes në detyrë, apo transferimit të besueshme dhe të bazuara në standarde të pranuar ndërkombëtare, të vlerësuara edhe nga monitoruesit ndërkombëtarë të këtyre proceseve. Këshilli duhet të promovojë qasjen e ndryshimit të vazhdueshëm dhe avancimit të proceseve të punës, në këtë drejtim, duhet të synohet që prokurorët të bësojnë në punën e tyre dhe në drejtësinë Këshillit.  
Gjithashtu duhet synuar eliminimi i sfidës me të cilën është ballafaquar për një kohë të gjatë, prokurori, numri i madh i procedimeve të mbartura, duke ofruar mbështetje për prokuroritë që kanë numrin më të madh të tyre, përmes transferimeve të përkohshme ose masave të tjera ligjore adekuate. Krahas proceseve të lartpërmendura, në baza të rregullta do të analizohet numri i prokurorëve për secilën prokurori, relevanca me ngarkesën në punë, kurse në përshtatshmëri do të mbahen edhe proceset e transferimit dhe ngritjes në detyrë. Me këtë do të mundësohet edhe zhvillimi në karrierë për prokurorët ambiciozë, duke u mbështetur në rezultatet e punës.
- ✓ **Fuqizimi i metejshëm i vlerësimit të performancës së prokuroreve.** Vlerësimi i performancës së prokurorëve është proces esencial për avancimin e mëtejshëm të efikasitetit dhe profesionalizmit të institucionit të Prokurorisë. Tashmë, sistemi i vlerësimit të performancës është miratuar, por nuk është konsoliduar. Këshilli duhet të vlerësojë dhe të krijojë bazë të mirë për avancimin e të këtij sistemi. Në këtë aspekt, duhet të ketë përqëndrim në vlerësimin e sistemit aktual, elaborimin e praktikave më të mira ndërkombëtare dhe propozimin për rishikim të këtij sistemi, i cili në fokus do të ketë objektivitetin, meritokracinë dhe parashikueshmërinë në procesin e vlerësimit të performancës. Në procesin e vlerësimit do të konsultohen dhe punohet bashkërisht me partnerët ndërkombëtarë, me qëllim të krijimit të një sistemi efikas dhe të qëndrueshëm, i cili mbështet zhvillimin e karrierës së sistemit prokurorial.
- ✓ **Rritja e transparencës dhe bashkëpunimit.** Transparenca dhe komunikimi me mediat, publikun dhe shoqërinë civile konsiderohet si çelës dhe garantues të suksesit për veprimtarinë e KLP-së. Këshilli në këtë periudhë të funksionimit të tij ka pasur angazhim të shtuar për forcimin e këtyre komponentëve, por konsiderojmë se ky angazhim duhet vazhduar edhe më tutje. Këshilli do të vazhdojë të ketë transparencë në punën e tij qoftë nëpërmjet takimeve të hapura, por edhe të formave të tjera të komunikimit. Zhvillimi i kapaciteteve të resurseve njerëzore në fushën e komunikimit publik dhe nxjerrja e një udhëzuesi praktik janë synime të Këshillit, me qëllim të ngritjes së rolit proaktiv në komunikimin publik.  
Duke parë realitetin mediak aktual, në të cilin shpesh herë prokurorët të caktuar janë vënë në qëndër të tyre, duhet krijuar një praktikë efikase për adresimin e kësaj problematike, e cila tashmë ka edhe një kornizë ligjore.

Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ndërkombëtare është i përcaktuar me ligjin organik, aktet e tjera nënligjore dhe strategjitë përkatëse. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare, me të cilat ndërvepron Këshilli, me theks të veçantë te: Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë, Shkolla e Magjistraturës, Policia e Shtetit, etj. Po ashtu, ky bashkëpunim do të përqendrohet edhe në zhvillimin e marrëdhënieve bilaterale me institucione të ngjashme evropiane dhe botërore. Këshilli mbetet i përkushtuar në përcaktimin dhe zbatimin e politikave të bashkëpunimit të hapur dhe profesional me institucione shtetërore dhe organizata të tjera vendore.

Angazhim maksimal do të ketë edhe në zbatimin e detyrimeve që dalin nga proceset e integritimit evropian dhe çfarëdo obligimi tjetër shtetëror. Themelimi i një mekanizmi koordinues do t'i ndihmonte zhvillimit të bashkëpunimit, i cili përmban kapacitetet e nevojshme kadrovike për hartimin dhe menaxhimin e projekteve të ndryshme, si dhe përgatitjen e rekomandimeve, që dalin si rezultat i projekteve.

- ✓ **Ngritja e kapaciteteve profesionale të prokurorëve.** Rezultatet pozitive në sistemin e prokurorisë nuk mund të arrihen pa një nivel të lartë të shkallës së profesionalizmit të prokurorëve dhe personelit mbështetës. Rëndësia e trajnimit të prokurorëve është e specifikuar në mekanizmat ndërkombëtarë, si në: Parimet themelore të OKB-së për pavarësinë e Gjyqësorit, të miratuara në vitin 1985, por edhe me aktet e Këshillit të Evropës, si: Rekomandimi nr. R (94) 12 për pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve, i miratuar në vitin 1994, Karta Evropiane për Statutin e Gjyqtarëve, e cila i referohet paragrafit 11 të Opinionit nr.1 të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE), në vitin 1998. Në frymën e këtyre akteve janë edhe rekomandimet dhe opinionet e Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropianë (CCPE). Këshilli do të krijojë mekanizma të nevojshëm për të mbështetur Shkollën e Magjistraturës, të cilat janë autoritete përgjegjëse për zhvillimin dhe cilësinë e programeve trajnuese dhe trajnimeve, për vlerësimin e nevojave për trajnime, pjesëmarrjen në trajnime dhe programe shkëmbimi, si dhe për krijimin e infrastrukturës së nevojshme për vlerësimin e ndikimit të trajnimeve. Programet trajnuese duhet të hartohen në koordinim me Këshillin. Këshilli duhet të angazhohet për avancimin e proceseve të përcaktimit të politikave për trajnime, duke u fokusuar në zhvillimin e kompetencave profesionale dhe interdisiplinare, si dhe duke krijuar mundësi të barabarta të pjesëmarrjes në trajnime për të gjithë prokurorët, në mënyrë që kjo pjesëmarrje të jetë mbështetje e fuqishme për zhvillimin e karrierës profesionale.
- ✓ **Përmirësimi i procesit të punës për shqyrtimin e përformancës së prokurorëve.** Duhet të krijohet një njësi e posaçme për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve, si pjesë përbërëse e Këshillit për të rritur saktësinë e të dhënave statistikore të sistemit prokurorial dhe hartimit të raporteve përmes bashkëpunimit intensiv dhe të vazhdueshëm me drejtuesit e prokurorëve. Duke kontribuar në përcaktimin e raporteve standard, që do të rrisë më tej transparencën e sistemit të prokurorisë. Në këtë aspekt nuk është mundësuar akoma që raporte analitike të



ndryshme përmes analizave krahasuese, trendëve dhe cilësisë së punës të jenë të ekzistuese, të cilat do të mbështetësin Këshillin në ushtrimin e mandatit të tyre.

- ✓ **Përmirësimi i hartimit të raporteve analitike përmes sistemit të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave.** Duhet fokusuar që baza elektronike e dosjeve të prokurorëve të jetë tërësisht funksionale dhe mjeti kryesor i punës, gjë që edhe do të mundësohet që menaxhimi i proceseve të punës në masë të madhe të jetë në formën digjitale. Pastaj avancim dhe raporte shtesë analitike për performancën e prokurorëve dhe mbështetje për komisionet e Këshillit në proceset e rekrutimit, transferimit, avancimit, vlerësimit të performancës së prokurorëve dhe administrimit të prokurorive, përfshirë dhe vlerësim të nevojave për trajnime dhe koordinim të aktiviteteve trajnuese për zhvillimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe personelit administrativ.
- ✓ **Ngritja e kapaciteteve në mbështetje të zhvillimit profesional të sistemit të prokurorisë.** Zhvillimi i kapaciteteve profesionale brenda sistemit të prokurorisë do të marrë angazhimin maksimal të një njësie (komisioni) të posaçme. Kjo do të bëhet me fuqizimin e rolit dhe kapaciteteve të njësisë për Trajnime për të marrë rol më proaktiv në procesin e vlerësimit të nevojave për trajnime, pjesëmarrjen në trajnime, rekomandimet për organizim të trajnimeve, e, veçanërisht në periudhën pas trajnimeve për vlerësimin e ndikimit të trajnimeve në performancën e punës së prokurorëve dhe stafit administrativ të përfshirë në trajnime. Kjo njësi do të japë kontribut në procesin e hartimit të politikave për trajnime dhe rregullores përkatëse për ngritjen e kapaciteteve profesionale në sistemin e prokurorisë.
- ✓ **Mekanizma kontrolli të ushtrimit të funksionit.** Nëse marr bësimin e kolegëve platforma do të jetë e vlefshme dhe zbatohet për periudhën e mandatit si anëtar i KLP. Gjatë kësaj periudhë do të organizoj takime periodike me qëllim rishikimin e performances time deri në atë kohë dhe përcaktimin e mëtejshëm të hapave konkret që do të ndiqen për përmbushjen e platformës në mënyrë të plotë.  
Në procesin e monitorimit të zbatimit të saj, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mendimit dhe propozimeve të gjitha prokurorive të cdo niveli në sistemin e prokurorisë. Madje një ndihmë të madhe në këtë process do të luanin shoqatat e prokurorëve, të cilat do të siguronin një ndikim më efektiv në vlerësimin e platformancës, dhe për rrjedhojë do të garantonte zbatimin e platformës së votbësuar nga prokurorët.

Me shumë konsideratë,

**Zeqir HODA**

**Prokuror i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë**

**Tiranë, më 30.12.2020**